



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE" VLORE

VENDIM
Nr. 11 , Data 23.07.2012

Per miratimin e kerkeses per marrje Leje, per perdorim te rezerves ujore, prej burimeve ujore te Tatzatit, per prodhim te energjise elektrike, nepermjet HEC-it "Sasajt", prej subjektit "Energo Sas" sh.p.k, me Administrator Z.Vasil Gjika, Sarande.

Ne plotesim te kerkeses te bere prej subjektit "Energo Sas" sh.p.k dhe ne zbatim te kerkesave te Ligjit Nr.8093, Dt.21.03.1996 "Per Rezervat Ujore", te ligjit nr. 9663, dt. 18.12.2006 per koncesionet, vendimit te K.M nr. 27, dt. 19.01.2007 "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies te koncesioneve", vendimit nr.3, dt.19.07.2002 te K.K.U-se "Per miratimin e rregullores te sekretariatit teknik te K.K.U, te K.B.U dhe te A.U-it, udhezimit te M.M.P.A.U dhe M.E.T.E, vendimit nr. 634, dt. 18.09.2003 te K.M, "Per fillimin e procedures se ndertimit me koncesion te formes BOO te hidrocentralit te Sasajt", vendimit nr.501 Dt.23.07.2004 te KM "Per miratimin e marreveshjes se koncesionit te formes BOO, ndermjet Ministrise se Industrise dhe te Energjitikes, e Ministrise te Bujqesise dhe ushqimit si organ shtetror i autorizuar (O SH A) per ndertimin e hidrocentralit te Sasajt", botuar dhe ne fletoren zyrtare me Nr. 58, Dt. 18.08.2004, si dhe vendimit Nr.6, Dt.04.12.2006 te K.B.U "Vjose" per dhenien e vendimit "Miratim ne parim te kerkeses per koncesion per perdorimin e ujit te burimeve te Tatzatit, per ndertimin e hidrocentralit te Sasajt", dhene ky vendim subjektit "Energo Sas" sh.p.k, si dhe duke marre ne konsiderate rikerkesen e subjektit "Energo Sas" sh.p.k.

K.B.U Vjose:

VENDOSI:


- 1- Miratimin e kerkeses te bere nga subjekti "Energo Sas" sh.p.k, per dhenie leje "Per perdorim te rezerves ujore" per prodhim te energjise elektrike, nepermjet HEC-it "Sasajt", duke perdorur burimin uhor "Burimet e Tatzatit, Komuna Lukove, Rrethi Sarande, Qarku Vlore.
- 2- Vepra e marrjes do te jete ne vendin me koordinata:
 $X = 44\ 33\ 178$ $Y = 44\ 09\ 340$ $Z =$ m
- 3-Sasia e ujit qe jepet ne perdorim per prodhim te energjise elektrike, per HEC-in "Sasajt" do te jete $3.2\ m^3/sek.$
- 4- Perdoruesi i ujit subjekti "Energo Sas" sh.p.k eshte i detyruar qe ne periudhen nga 01 Maj deri me 30 shtator te cdo viti te mos cenoj regjimin e ujitjes si dhe gjithashtu te mos demtoj nenveprat qe sherbejne per marrjen e ujit nga kanalet ujitese

•Vazhdim i Vendimit Nr. 11 , Dt. 23.07.2012.

5- Ngarkohet A.U.B “Vjose” per zbatimin e ketij vendimi.

6- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJES I A.U.B “VJOSE”
Ardian DINE



KRYETARI I K.B.U “VJOSE”
Eduart VELCANI

